



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN  
E MJEDISIT TË KOSOVËS

KOSOVSKA AGENCIJA  
ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO ENVIRONMENTAL  
PROTECTION AGENCY

---

INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS

## **RAPORT NGA CENSUSI NDËRKOMBËTAR I SHPENDËVE TË UJIT NË KOSOVË**

Prishtinë, Janar 2020

Page 1 of 4



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK-MMPH)  
Adresa: Rruga "Luan Haradinaj" Ndertesa e Re e Qeverise, kati XV/04, 10000 Prishtinë  
Tel. 038/20033228, e-mail & web: [KEPA@rks-gov.net](mailto:KEPA@rks-gov.net), [www.ammk-rks.net](http://www.ammk-rks.net)

Në kuadër të aktiviteteve për monitorimin dhe inventarizimin e biodiversitetit, gjatë fundjavës së kaluar (11-12.01.2020) Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës me ndihmën e vullnetarëve nga "Wildlife Albanian Photographers - WAPH", "Kosova Wildlife Care - KWC" si dhe ekspert e dashamir të natyrës kanë kryer për herë të dytë me radhë në Kosovë Censusin Ndërkombëtar të Shpendëve të Ujit.

Ky aktivitet i realizuar në kuadër të IWC 2020 (International Waterbird Census) që organizohet në nivel botëror, që prej 54 vitesh, nga Wetlands International përfshiu pothuajse të gjitha vendet ku ka prezencë të baseneve ujore.

Duke marrë parasysh të ftohtit e këtyre ditëve Liqeni i Livoqit dhe ai i Përlepticës ishin plotësisht të ngrira andaj edhe nuk u vizituan fare. Liqeni i Vërmices që ishte thuajse pa ujë për shkak të rënies së nivelit të ujit, përveç nje pjese të sipërfaqeve ujore të mbetura që ishin të ngrira nuk u vizitua gjithashtu. Liqeni i Vasileves si dhe Ligatina e Hencit edhe pse të ngrirë janë vizituar nga ekipa e terrenit me ç`rast janë evidentuar vetëm disa lloje te shpendeve jo-ujore.

Të vetmet sipërfaqe, pjesërisht të ngrira, ku kishte shpendë uji ishin Liqeni i Badovcit, Liqeni i Batllaves, Liqeni i Radoniqit si dhe liqeni i vogël përreth termocentralit të Obiliqit (në afërsi të Deponisë së Mbeturave në Mirash) ku edhe strehohej një numër i madh i shpendëve të ujit.

Nga rezultatet e mbledhura mund të konstatohet se u vrojtuan 12 lloje të shpendëve të ujit me një numër total prej gjithsej 9.334 individësh. Shumica e shpendëve të ujit të numëruar me këtë rast ishin *Anas platyrhynchos* me 7315 individë, *Anas crecca* me 1330 individë dhe *Chroicocephalus ridibundus* me 453 individë që përbënin së bashku 97,49% të numrit të përgjithshëm të shpendëve.

Lista complete e shpendëve ujorë është si më poshtë:

Nr.	Llojet shpend uji	Radoniq	Henc	Obiliq	Badovc	Batllavë	Rrjedha e Drinit - Kralan-Rogovë	Vasilevë	Total
1	<i>Anas crecca</i>	45		1285					1330
2	<i>Anas platyrhynchos</i>	2930		2878	93	1350	64		7315
3	<i>Ardea alba</i>						3		3
4	<i>Ardea cinerea</i>			3			4		7
5	<i>Chroicocephalus ridibundus</i>			453					453
6	<i>Fulica atra</i>	34		68					102
7	<i>Gallinula chloropus</i>						5		5
8	<i>Gavia arctica</i>	2							2
9	<i>Phalacrocorax carbo</i>	14			8	65	7		94

10	<i>Podiceps cristatus</i>	8							8
11	<i>Tachybaptus ruficollis</i>			4			6		10
12	<i>Tringa ochropus</i>						5		5
	<b>TOTAL</b>	<b>3033</b>	<b>1</b>	<b>4691</b>	<b>101</b>	<b>1415</b>	<b>94</b>	<b>0</b>	<b>9334</b>

Në Liqenin e Radoniqit, përveç shpendëve të tjerë edhe këtu u vërejt praninë e *Gavia arctica*. Ky lloj përveç në vitin e kaluar gjithashtu është konstatuar gjatë një ekspedite të realizuar në Shtator të këtij viti dhe llogaritet si një e gjetur mjaftë me rëndësi jo vetëm për këtë zonë por në përgjithësi për vendin për shkak të mungesës së të dhënave të mëhershme për praninë e saj tek ne.

Zonat kryesore për shpërndarjen e shpendëve të ujit rezultojnë të jenë Liqenet e Obiliqit (pranë deponisë së hirit të termocentralit), Liqeni i Radoniqit dhe ai i Batllavës, si të vetmet sipërfaqe ujore që nuk ishin të mbuluara nga akulli.

Përveç ligatinave të mësipërme në këtë census është përfshirë edhe një pjesë e rrjedhës së mesme e Drinit të Bardhë nga Kralani e deri në Rogovë për të vazhduar në vitet tjera përfshirjen e rrjedhave tjera lumore si të vetmet pjesë ujore jo të ngrira gjatë periudhës së dimrit.

Përveç shpendëve të ujit që ishin në fokus të këtij aktiviteti, edhe këtë herë në zonat ligatinore u evidentuan shpendët jo-ujorë që i përdorin këto ekosisteme për tu ushqyer gjatë periudhës së dimërimit.

Nr.	Llojet shpendëve jo-ujore	Radoniq	Henc	Obiliq	Badovc	Batllavë	Rrjedha e Drinit - Kralan-Rogovë	Vasilevë	Total
1	<i>Buteo buteo</i>	2	4	5		2	4		17
2	<i>Carduelis carduelis</i>	12	135		24	8			179
3	<i>Columba livia</i>	18	4	21					43
4	<i>Coloeus monedula</i>			32		18	2	3	55
5	<i>Corvus cornix</i>	2	2	28		11			43
6	<i>Corvus frugilegus</i>			4		2			6
7	<i>Dendrocopos major</i>	1			1	3	2		7
8	<i>Emberiza schoeniclus</i>		2						2
9	<i>Erithacus rubecula</i>				2	6	4		12
10	<i>Falco tinnunculus</i>			2			1		3
11	<i>Fringilla coelebs</i>	1			8	2	3	2	16
12	<i>Garrulus glandarius</i>				2		4	3	9
13	<i>Linaria cannabina</i>						42		42
14	<i>Motacilla alba</i>				1		4		5
15	<i>Parus major</i>	2		2			5		9
16	<i>Passer domesticus</i>	12			8				20

17	<i>Passer montanus</i>		2	12	14	6		4	38
18	<i>Pica pica</i>	2	2	4	3		8	2	21
19	<i>Regulus regulus</i>						2		2
20	<i>Turdus merula</i>		2			1		6	9
	<b>Total</b>	<b>52</b>	<b>153</b>	<b>110</b>	<b>63</b>	<b>59</b>	<b>81</b>	<b>20</b>	<b>538</b>

Censusi 2020 si vazhdim i atij të vitit të kaluar vazhdon t`i shërbej njohjes më të mirë të vlerave dhe rëndësisë së eksositemeve ligatinore të Kosovës për shpendët e ujit me qëllim të mbrojtjes më të mirë dhe menaxhimit të duhur të tyre në të ardhmen.

Pjesë e ekipës:

Qenan Maxhuni - IKMN

Arian Mavriqi - WAPH

Lulzim Demaj - WAPH

Besnik Fetiu - WAPH

Albert Krasniqi - KWC

Rifat Përçuku - KWC

Jeton Muhaxhiri - ekspert i pavarur

Adon Pajaziti - dashamir i natyrës

Aldin Maxhuni - dashamir i natyrës